



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT

<b>Drejtoria</b>	<b>Drejtoria e Shëndetësisë</b>
<b>Periudha Raportuese</b>	<b>Tetor, 2021</b>
<b>Përmes</b>	<b>Muhamet Pervetica, u.d. udhëheqës i Sektorit të shëndetësisë - DSH</b>
<b>Raportuesi</b>	<b>Dr. Fatlinda Hoxha, zyrtare për shëndetësi - DSH</b>

#### 1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes, ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Gjatë muajit tetor 2021, Drejtoria e Shëndetësisë pranoi 42 lëndë, të cilat ishin për kategorinë e subvencioneve mjekësore, përderisa 2 prej tyre ishin kërkesa të kategorive të ndryshme.

Stafi në këtë drejtori kishte takime të përditshme me qytetarë, për t'u njoftuar me procedura dhe me shërbime sipas interesit dhe kërkesave të tyre.

#### 2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramin e Komunës për drejtorinë tuaj.

- Furnizime të ndryshme bazuar në kontratat aktive;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së punës në përditshmëri të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saj, si dhe në QMU;
- Inicimi i përgatitjeve administrative, zbatimi i plan prokurimi 2021;
- Përpilimi i raporteve të ndryshme në kuadër të drejtorisë.

### 3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë:

- Gjatë muajit tetor u ofruan shërbime falas të mamografisë për të gjitha gratë e komunës së Prishtinës;
- Aktiviteti u realizua përmes caktimit të termineve në QKMF, ndërsa u zhvillua në objektet e QKMF dhe QMF 5;
- Sllogani ishte: Zbulimi i hershëm shpëton jetë;
- Në shërbimin e radiologjisë në QKMF dhe QMF 5, gjatë muajit tetor u realizuan gjithsej 288 mamografi, shërbim ky falas për qytetarët e Prishtinës;
- Nga data 8 tetor, në zyrat e DSH-së qytetarët filluan të pajisen me vërtetime të cilët ishin diagnostikuar me COVID - 1;
- Përgjatë periudhës raportuese, 250 qytetarë u pajisën me vërtetimet në fjalë;
- Ndërkaq, për ofrimin e ndihmës së menjëhershme të qytetarit në rast të arrestit kardiak, deri në ardhjen e ndihmës mjekësore urgjente vendosen instrumentet defibrilatorët, fillimisht në dy objekte të Komunës së Prishtinës, institucionet arsimore dhe NPL “Statcioni i Autobusëve”;
- DSH mbajti takim së bashku me “Kosovo Legal Services Company”, e cila në kuadër të Autoritetit Qeveritar të Migrimit, implementon me projektin e financuar nga MIMAK-ICMPD “Vlerësimi i Sistemit të Migrimit të Brendshëm në Kosovë”;
- Fillon administrimi i vaksinës kundër gripit sezonal, nga data 28 tetor 2021, në sallën “1 Tetori” nga ora 8:00 deri në orën 19:00, prandaj nga data 28.10.2021 deri më 09.11.2021, u administruan 5100 doza të vaksinës kundër gripit sezonal;
- Përgjatë periudhës raportuese u nënshkruan kontratat e listuara;
  - “Furnizimi me uniforma për personelin shëndetësor QKMF dhe QMU-së, Loti 2”;
  - “Furnizimi emergjent me D-Dimer për nevojat e QKMF-së” dhe
  - “Furnizim me autovetura për shërbimet shëndetësore”;
- Informata shtesë u kërkua për aktivitetin - Deratizimi i bodrumeve dhe garazheve publike, si dhe rrjetit të kanalizimit në Komunën e Prishtinës;
- Caktohet ekipi menaxhues - Furnizimi me uniforma për personelin shëndetësor QMU-së, Lot II dhe;
- Furnizim me autovetura për shërbimet shëndetësore”, ritender;

- Caktohet ekipi vlerësues dhe menaxhues “Furnizimi emergjent me D-Dimer për nevojat e QKMF-së”.
- Gjatë periudhës raportuese, situata me pandeminë ishte: 204 raste të reja, 0 vdekje dhe 90 raste aktive.

#### **4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR**

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:

- Përgatitja e specifikave bazuar në planprokurimi 2021;
- Përgatitje rreth përpilimit të planprokurimi 2022;
- Mbikëqyrje e vazhdueshme të punës së përditshme të personelit shëndetësor në objektet shëndetësore rreth mbarëvajtjes së punës;
- Përgatitje teknike rreth vlerësimit të lëndëve rreth subvencioneve – shëndetësore;
- Përgatitje teknike dhe administrative mbi fillimin e muajit për ekzaminime radiologjike – mamografi.

#### **5. STATISTIKAT**

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar me buxhetin e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj.

Shtoni kategoritë sipas nevojës.

**5.1.1.** Buxhetin e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese.

**5.1.2. Takimet me palë.**

- Çdo dite nga ora 9:00 deri në orën 15:00 DSH bën pranimin e palëve.

**5.1.3. Takimet me institucione tjera.**

- Drejtoria e Prokurimit:
  - o Procedura rreth kontratave të ndryshme

**5.1.4. Diskutime publike, takimet me qytetarë**

**5.1.5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare**

### **5.1.6. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër**

Gjatë muajit tetor 2021, Drejtoria e Shëndetësisë pranoi 42 lëndë, të cilat ishin për kategorinë e subvencioneve mjekësore, përderisa 2 prej tyre ishin kërkesa të kategorive të ndryshme.

### **5.1.7. Përfitues të subvencioneve**

Në komisionin e mbajtur më 19.10.2021 u përkrahën 211 raste.

### **5.1.8. Takime të tjera**

## **6. SFIDAT**

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë:

- Mungesa e stafit në DSH;
- Numri jo i mjaftueshëm i stafit shëndetësor, bazuar në nevoja të qytetarëve;
- Buxhet jo i mjaftueshëm sidomos për kategorinë “Mallra dhe shërbime”, ku me rritjen e numrit të pacientëve dhe shërbimeve, rrezikojmë shërbimet e vazhdueshme deri në fund të vitit.

## **7. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR PERIUDHEN PASUESE**

- Përgatitjet për publikimet e tenderëve bazuar në planin e prokurimit;
- Monitorim i përditshmërisë së personelit për të ndikuar në shërbime shëndetësore cilësore dhe të qasshme.

## **8. TË TJERA**

Shënimi çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.

## **QENDRA E MJEKËSISË URGJENTE**

Qendra e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë, gjatë muajit tetor 2021, ofroi shërbime shëndetësore urgjente për qytetarët e Prishtinës dhe fshatrave të Komunës me ekipe mjekësore dhe autoambulanca.

### **Patologjia dhe shërbimet**

Nga raportimet e stafit mjekësor përmes përgjegjësve të turneve, rastet urgjente janë trajtuar sipas prioriteteve të triazhës së urgjencës, rastet me frekuencë më të lartë:

- Hipertension arterial;
- Astma bronchiale;
- Sëmundjet pulmonare obstructive kronike;
- Gjendjet febrile me temperatura të larta;
- Kokëdhimbjet akute;
- Abdomeni akut;
- Sindromi akut koronar;
- Ataquet ischemike tranzitore;
- Colicat renale;
- Ataquet cerebrovasculare;
- Pneumonitë atipike, post Covid 19;
- Lëndimet nga aksidentet e trafikut;
- Lëndimet aksidentale etj.

### **Edukimi i vazhdueshëm profesional**

Në kuadër të EVP-së përmes platformës elektronike ZOOM, më 21.10.2021, në ora 16:30 deri në ora 18:00 është mbajtur ligjerata: "Krizat hipertensive, komplikimet, menaxhimi dhe kujdesi ndaj këyre pacientëve në kushte paraspitalore.

### **Situata me pandeminë COVID -19**

Duke përcjell situatën epidemiologjike gjatë muajit Tetor dhe nga informatat që kemi nga IKSHP, kemi një përmirësim dhe zvogëlim të rasteve me COVID-19, të formës delta;

Ekipet tona janë përgjigjur në thirrje, duke iu ofruar ndihmë në shtëpi dhe transport me ekip mjekësor dhe autoambulancë deri në klinikat e QKU-së, ku trajtohen rastet me COVID-19;

Gjatë muajit tetor, nga kolektivi nuk kishte asnjë punonjës të infektuar me COVID-19;

Gjatë muajit tetor, në 7 ditë të javës prej orës 07:00 deri në orën 20:00, një ekip mjekësor nga QMU-ja, ka vazhduar kujdestarit në sallën 1 tetori për të ofruar kujdes mjekësor për të gjithë personat që kanë pasur nevojë për tretman dhe këshilla mjekësore gjatë vaksinimit;

Nga data 15 tetor me vendim të Ministrisë së Shëndetësisë është ndërprer vaksinimi gjatë vikendeve dmth të shtunave dhe të dielave, ky vendim është në fuqi edhe gjatë muajit nëntor;

Konform kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë -komitetit për imunizim të popullatës me vaksinën kundër COVID-19, më **22, 28 dhe 29.10.2021** nga ora **10:00 deri në orën 17:30** në Sheshin “Zahir Pajaziti”, një ekip mjekësor me autoambulancë ka mbështetur fushatën e vaksinimit;

Gjatë kësaj kohe qytetarët nga ekipet e QKMF-së janë vaksinuar vullnetarisht pa asnjë lloj procedure administrative;

Ekipet mjekësore kanë intervenuar për çdo krkesë ose shqetësim të qytetarëve dhe fatmirësisht deri tani nuk kemi pasur raste të rënda urgjente;

Nga ekipet mjekësore deri tani nuk është raportuar asnjë rast i komplikimeve postvaksinale, përveq nevojës për këshilla ose ndonjë ekzaminim si matje të shtypjes së gjakut, pulsit, saturimit të oksigjenit, matjes së sheqerit për personat me sëmundje kronike dhe këshilla.

### **Mbështetja e manifestimeve sportive**

Ekipet mjekësore të QMU-së me autoambulanca kanë mbështetur stervitjet dhe ndeshjet sportive sipas kërkesës zyrtare të Federatës së futbollit të Kosovës;

Më 04.10.2021 nga ora 19:00 deri në orën 20:00, mbështetje, stërvitjes së

reprezentacionit të Kosovës në stadiumin “Fadil Vokrri” me një ekip mjekësor;

Më 05.10.2021 nga ora 11:30 deri në orën 12:30 në stadiumin “Fadil Vokrri” mbështetje stërvitjes së reprezentacionit të Kosovës, me një ekip mjekësor;

Më 06.10.2021 nga ora 12:00 deri në orën 13:00, mbështetje reprezentacionit të Kosovës në stërvitje në stadiumin në Hajvali me një ekip mjekësor;

Më 07.10.2021 nga ora 12:00 deri në orën 13:00 mbështetje reprezentacionit të Kosovës në stërvitje në stadiumin në Hajvali me një ekip mjekësor;

Më 10.10.2021 nga ora 13:30 deri në orën 14:30, mbështetje reprezentacionit futbollistik të Kosovës në stërvitje në stadiumin “Fadil Vokrri” ka asistuar një ekip mjekësor;

Më 11.10.2021 nga ora 16:30 deri në orën 17:30 mbështetje stërvitjes së reprezentacionit futbollistik në stadiumin “Fadil Vokrri”, asistencë me një ekip mjekësor;

Më 12.10.2021 nga ora 18:30 deri në orën 23:30 mbështetje në ndeshjen futbollistike Kosova dhe Gjeorgjia e zhvilluar në stadiumin “Fadil Vokrri” e vlefshme për kualifikim në kampionatin botëror të futbollit;

Më 06.10.2021 nga ora 16:30 deri në orën 19:30 me një autoambulancë dhe ekip mjekësor është mbështetur ndeshja futbollistike për grup moshat e reja mes kombëtares së Kosovës dhe Çekisë, në stadiumin “Fadil Vokrri”;

Më 07.10.2021 nga ora 10:00 deri në orën 11:00, auto ambulanca me një ekip mjekësor ka mbështetur stervitjet e grup moshave të reja stadiumin e KF “Ramiz Sadiku”;

Më 12, 13 dhe 14.10. 2021 nga ora 13:00 deri në orën 16:00 kemi asistuar në turnirin futbollistik për grup moshat e reja i cili është mbajtur në stadiumin e Hajvalisë;

Më 19.10.2021 nga ora 13:00 deri në orën 16:00 kemi asistuar me një auto ambulancë në turnirin e organizuar nga FFK-ja për grup moshat e reja, në stadiumin e Hajvalisë;

Turniri ka vazhduar edhe më 27 dhe 28.10.2021 nga ora 10:00 deri në orën 13:00 dhe QMU ka asistuar me një ekip mjekësor dhe autoambulancë në stadiumin e Hajvalisë;

Këto kanë qenë aktivitetet dhe angazhimet kryesore të stafit shëndetësor në punë gjatë muajit tetor, 2021.

Nr.	Lloji i shërbimit	Nr.
1	Vizita mjekësore në terren	1250
2	Vizita mjekësore në QMU	9
3	Aksidentet në trafik	99
4	Fatkeqësi të tjera	75
5	Fatkeqësi tjera	3
6	EKG	18
7	Transporte	284
8	Konstatim vdekjeje	47
Gjithsej		1784

## ZYRA E PROKURIMIT NË QMU

### ❖ AKTIVITETET E PLANIFIKUARA:



- Zhvillimi i aktiviteteve të procedurave të prokurimit sipas prioriteteve dhe kërkesave nga njësitë kërkuese;
- Bashkëpunimi i Zyrës së prokurimit për kontratat e lidhura në Komunë dhe bashkëpunimi sipas UA, 2016 të LPP me AQP për kyçe në kontratat e centralizuara;
- Sipas LPB-së, bashkëpunimi me drejtorin e QMU-së për caktimin e komisioneve dhe punimin e vendimeve, nënshkrimi dhe protokollimi për vlerësimin e ofertave, pranimit të mallrave, shërbimeve, caktimin e menaxherëve të kontratave etj.
- Sipas nevojave të paraqitura.

### ❖ AKTIVITETET E ZBATUARA

- Nxjerrja e urdhër-blerjeve në sistemin Freebalanc për të gjitha faturat për kontratat që lidhen në QMU dhe faturat e kontratave të AQP-së të cilat i shfrytëzon QMU-ja;
- Pranimi i kërkesës dhe dokumentet tjera përcjellëse për fillimin e procedurës për furnizim me material administrativ shëndetësor në QMU;
- Punimi i DT në platformën e E-prokurimit;

- Njoftimi për kontratë;
- Hapje e ofertave dhe dërgesa e procesverbalit të hapjes tek OE.
- 

#### ❖ **AKTIVITETET NË ZBATIM E SIPËR**

- Takime me palë të ndryshme, kompletimi i lëndëve për pagesa dhe aktivitete tjera sipas nevojës .
- Vazhdimi i procedurës dhe vlerësimi i ofertave për procedurën në fjalë.

### **ZYRA E FINANCAVE NË QMU RAPORT PUNE PËR MUAJIN TETOR, 2021**

#### ❖ **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA**

- Mbajtja e një takimi me stafin udhëheqës ne lidhje me zotimet e investimeve kapitale dhe zotimet për mallra dhe shhërbime.
- 

#### ❖ **AKTIVITETE TE PËRFUNDUARA**

- Përgatitja e lëndëve të poshtë shënuara për pagesë dhe fotokopjimi i tyre ;
- Shpenzimet e telefonit për muajin shtator;
- Shpenzimet e tel. në “Xhemail Ibishi” për muajin shtator;
- Shpenzimet e rrymës për muajin shtator;
- Shpenzimet për mirëmbajtjen e autoambulancave;
- Mbushje telefonike për punëtorë për muajin shtator;
- Furnizim me ujë për pije për muajin shtator;
- Shfrytëzimi i automjetit me qira për muajin shtator;
- Furnizim me karburante për muajin shtator;
- Përcjellja e pagave me ndryshime – pushime të lehonisë, largime nga puna etj. për muajin shtator;
- Përgatitja e pagave për 3 punëtorët me kontrata për punë specifike për muajin tetor;
- Përgatitja e formularëve me dokumente përcjellëse për punëtorët e rinj.
- 

#### ❖ **AKTIVITETE NË ZBATIM E SIPER**

- Faturat te cilat duhet të përgatiten për pagesë;
- Fatura e rrymës;
- Sigurimi i autoambulancave;
- Mirëmbajtja e fotokopjes me qira dhe printerëve;
- Mbushje telefonike për punëtorë;
- Përgatitja e ndërrimeve të natës;
- Përgatitja e faturave komunal (rrymë, ngrohje, PTK) të cilat janë të rregullta se bashku me faturat e karburanteve dhe automjetit me qira si dhe pagesat dhe shërbimet tjera;



- Kontrollimi i arkës dhe mbarëvajtja e parasë së imtë.

Faturat e lartë cekura janë të rregullta çdo muaj dhe duhet të përgatiten me të gjitha dokumentet përcjellëse dhe të dërgohen në DSH.

## QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

### RRJEDHA E PUNËS

- Ka vazhduar organizimi i brendshëm i përshtatur me situatën epidemiologjike, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore:
  - Tri qendra të mjekësisë familjare (QKMF, QMF 4 dhe QMF 5) kanë vazhduar punën pa ndërprerje (24/7) në ndërrime të zakonshme (07:00 deri në orën 13:30; 13:30 deri në orën 20:00 dhe 19:00 deri në orën 07:00);
  - Të gjitha qendrat e mjekësisë familjare punojnë me orar të rregullt (07:00 deri në orën 13:30, 13:30 deri në orën 20:00);
  - Të gjitha qendrat e mjekësisë familjare kujdestaria e rregulltë mujore e shtune (07:00 deri në orën 19:00) dhe e diele (07:00 deri në orën 13:00); Nga muaji tetor vikendet kthehen në normalitet (kujdestari tetëmbëdhjetë orëshe).
  - Në QMF 7 ka vazhduar të ofrohet edhe testi rapid antigjenik për qytetarët e Prishtinës janë punuar 1498 teste, ndërsa në QKMF edhe analiza e D-dimerit ku janë punuar 753 D-dimera, që të dyja këto falas;
  - Po ashtu janë punuar edhe testet serologjike 154 pacientë të testuar me teste serologjike;
  - Numri i konsultave virtuale gjatë muajit tetor ka arritur në 150 konsulta;
- Poliklinika e stomatologjisë dhe shërbimi stomatologjik orari i punës (07:00-15:00), shërbimi stomatologjisë në QMF 5 punon 24/7;
- Shërbimi pediatrik orari i punës (07:00 deri në orën 13:30 dhe 13:30 deri në orën 20:00);
- QMG orari i punës (07:00 deri në orën 15:00);
- Shërbimi specialistik orari i punës (07:00 deri në orën 15:00);
- Mjekësia e punës orari i punës (07:00 deri në orën 15:00);
- DAT orari i punës (07:00 deri në orën 13:00);
- Laboratori qendror orari i punës (07:00 deri në orën 14:00 -13:00 deri në orën 20:00);
- Radiologjia orari i punës (07:00 deri në orën 13:00), në funksion për momentin janë dy njësi radiologjike në QKMF dhe në QMF 5;
- Shërbimi i vaksinimit orari i punës (08:00 deri në orën 16:00), orari është përshtatur për arsye se pjesa më e madhe e punëtorëve shëndetësor nga data 29.03.2021 janë duke kontribuar në sallën 1 tetori, rreth vaksinimit të qytetarëve kundër COVID-19 dhe me

vaksinë kundër gripit, ku i kemi 8 ekipe të përbëra nga mjekë dhe infermier gjithsejtë 26 punëtorë nga QKMF dhe ekipet mbështetëse nga M.SH;

AMF-të (mjeku dhe infermieri punojnë çdo ditë pune nga ora 07:00 deri në orën 14:00, në Shkabaj, Mramor, Bardhosh, Lukar;

- Keqekollë punon tri ditë në javë ( e hëne, e mërkure dhe e premte );
- Koliq ( e marte ) punon mjeku, ndërsa infermieri çdo ditë;
- Dabishevc ( e enjte) ekipi komplet;
- Barilevë, Viti, Bullaj nuk punon tash për tash;
- Slivovë ( e marte, e enjte ) mjeku punon, ndërsa infermieri çdo ditë;
- Sharban, Rimanishtë, Kishnicë ( infermieri çdo ditë dhe higjienisti).

-Numri i stafit të infektuar gjatë muajit tetor nuk kemi asnjë punëtorë shëndetësor të infektuar.

Gjatë vizitave monitoruese në të gjitha qendrat e mjekësisë familjare (ndërrimi i paradites, pasdites dhe ndërrimi i natës) nuk janë konstatuar mangësi serioze.

- Respektohen rregullat e përgjithëshme, furnizimi qëndron mirë, masat mbrojtëse aplikohen.

Viz. mjekësore	Shërbimet shëndetësore	Shërbimet laboratorike	Shërbimet stomatologjike	Shërbimet radiologjike	Gjithsej
79105	58821	81250	11923	2510	233609

### **Poliklinika Stomatologjike QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE**

Numri i pacienteve ne shërbimin stomatologjik të QKMF-së Prishtine: 4696, numri me participim 640, të hyra 1438.00 euro;

Shërbimi i rëntgenit në poliklinikën stomatologjike QKMF, numri i grafive 480, numri me participim 153, të hyra 229.50 euro;

8 punëtorë në pushim mjekësor, 2 punëtorë në pushim të lindjes, 2 punëtorë me orar të shkurtuar për gji dhënie, 3 punëtorë te liruar ( shtatzëna);

Një vizitë me të gjithë stafin e ndërrimit ne QMF 5 dhe vizitë në shumicën e ordinancave në Poliklinikën stomatologjike;

Një takim me kryeshefin e QKMF-së, një furnizim me material shpenzues stomatologjik nga kontrata kornizë;

Furnizim me dy unite dentare, një në QMF një në Emshir dhe një në QMF 2.

